



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06 - 17370/26
Klinë, datë: 02.06.2026 22.06.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i parë publik për kornizën afatmesme buxhetore të viteve 2027-2029 të Komunës së Klinës, Kryetaret e kshillave lokal të komunës së Klinës, me datë 02.06.2026, ora 10:00, Salla e kuvendit të Komunës së Klinës.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 16/06/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimit në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.


Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i kornizes afatmesme buxhetore i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft korniza afatmesme buxhetore edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 10:00 të pranishëm ishin, Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtori i Administratës, Binak Syla, drejtori i financave, Faruk Smajli, anëtarë të grupit punues si dhe kryetaret e kishllav lokal.

Nga qytetarët morën pjesë 17 persona, prej të cilëve, 17 burra.

Shtojca 1 – Fotografi nga dëgjim i parë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me kryetaret e kshillav lokal e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga drejtori, z. Binak Syla, i cili përshëndeti të pranishmit dhe deklaroi:

“Përshëndetje të nderuar të pranishëm!

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Financat Publike dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna, sot po e hapim ciklin e dëgjimeve buxhetore për Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për periudhën 2027–2029.

Ky është një proces shumë i rëndësishëm për përcaktimin e prioriteteve të komunës për vitet e ardhshme. Në kuadër të këtij procesi do të pranojmë kërkesat, sugjerimet dhe komentet tuaja, të cilat grupi punues për hartimin e Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore do t'i shqyrtojë dhe analizojë me kujdes.

Në këtë takim janë të pranishëm Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, Drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, z. Faruk Smajli, si dhe anëtarët e grupit punues.”

Pas përfundimit të fjalimit të drejtorit Binak Syla, fjala iu dha Kryetarit të Komunës.

Fjala e Kryetarit të Komunës së Klinës

Prof. Dr. Zenun Elezaj përshëndeti të pranishmit dhe deklaroi:

“Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës,
Të nderuar kryetarë të këshillave lokale dhe përfaqësues të institucioneve,

Kam kënaqësinë që sot para jush të prezantoj Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2027–2029, një dokument strategjik që përcakton drejtimin e zhvillimit ekonomik, social dhe infrastrukturor të komunës sonë për tri vitet e ardhshme.

Qëllimi ynë kryesor mbetet përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimi i qëndrueshëm i çdo pjese të territorit të Komunës së Klinës. Përmes kësaj kornize buxhetore kemi planifikuar investime të rëndësishme në infrastrukturën rrugore, arsimin, shëndetësinë, kulturën, sportin, bujqësinë, mbrojtjen e mjedisit dhe shërbimet publike.

Gjatë viteve 2027–2029 do të vazhdojmë investimet në asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve lokale, ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përmirësimin e ndriçimit publik, si dhe krijimin e hapësirave të reja rekreative për qytetarët tanë.

Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet shkollave dhe institucioneve shëndetësore, duke investuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për nxënësit dhe qytetarët.

Po ashtu, do të mbështesim sektorin e bujqësisë dhe bizneset lokale përmes subvencioneve dhe projekteve zhvillimore, me synim fuqizimin e ekonomisë lokale.

Ky dokument është rezultat i planifikimit të kujdesshëm financiar dhe i nevojave të identifikuar në bashkëpunim me qytetarët dhe grupet e interesit. Prandaj, ftoj të gjithë qytetarët që të japin kontributin e tyre përmes sugjerimeve dhe komenteve, në mënyrë që prioritetet tona zhvillimore të reflektojnë sa më mirë nevojat e komunitetit.

Së bashku do të vazhdojmë të ndërtojmë një komunë më të zhvilluar, më moderne dhe më të mirë për të gjithë qytetarët e Klinës.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj.”

Pas fjalimit, Kryetari ftoi të pranishmit që të parashtrojnë kërkesat, pyetjet dhe rekomandimet e tyre.

Diskutimet

Kushtrim Haliti – Kryetar i Këshillit Lokal

“Përshëndetje Kryetar dhe të nderuar të pranishëm.

Kërkesa ime është që të rritet buxheti për Bashkësinë Lokale të Jashanicës, pasi shuma prej 40,000 euro nuk është e mjaftueshme për realizimin e nevojave të komunitetit.”

Përgjigja e Kryetarit

“Faleminderit shumë.

Gjatë prezantimit të Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore e theksova veçanërisht një projekt të fituar nga Granti i Performancës në vlerë prej 125,000 euro për fshatin Jashanicë. Edhe pse po përballemi me vështirësi financiare, përfshirë obligimet që rrjedhin nga kontrata kolektive, do të mundohemi që të jemi pranë jush dhe të shqyrtojmë me seriozitet çdo kërkesë të komunitetit.”

Rasim Murmullaku – Kryetar i Këshillit Lokal

“Përshëndetje Kryetar dhe të nderuar të pranishëm.

Pyetja ime është nëse janë të parapara rrethojat e varrezave për fshatrat Jellovc dhe Resnik, si dhe nëse do t’u jepet prioritet disa rrugëve lokale që janë të dëmtuara.”

Përgjigja e Kryetarit

“Faleminderit shumë.

Pothuajse të gjitha rrethojat e varrezave në këtë zonë janë të përfshira në planifikimin e projekteve për periudhën 2027–2029 dhe synimi ynë është që ato të përfundojnë brenda kësaj periudhe.”

Mark Gojani – Kryetar i Këshillit Lokal

“Përshëndetje Kryetar.

Ndriçimi publik në fshatrat Budisalc, Stupë dhe Rudic ka mbetur i papërfunduar. A ka ndonjë plan për vazhdimin e këtij projekti? Gjithashtu, kërkoj që disa rrugë fushore të përfshihen në projektet komunale për shtrimin e tyre, pasi po hasim vështirësi në punimin e tokave bujqësore.”

Përgjigja e Kryetarit

“Faleminderit Mark.

Jemi përpjekur që asnjë fshat të mos mbetet pa ndriçim publik, veçanërisht në rrugët kryesore. Edhe pse shumica e fshatrave tashmë janë të pajisura me ndriçim, do të vazhdojmë përpjekjet për të siguruar marrëveshje dhe fonde të reja me qëllim të kompletimit të rrjetit të ndriçimit publik në të gjithë territorin e Komunës së Klinës.

Përveç rrugëve kryesore, kemi filluar zgjerimin e rrjetit edhe në lagje dhe rrugica të fshatrave. Projekti ‘Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik’ është pjesë e planifikimit tonë buxhetor.

Sa i përket rrugëve fushore, ato do të trajtohen në planifikimet e ardhshme me qëllim që qytetarët të kenë qasje më të lehtë në tokat e tyre bujqësore.”

Emin Balaj – Kryetar i Këshillit Lokal

“Përshëndetje të gjithëve.

Unë jam Emin Balaj nga Bashkësia Lokale e Gllarevës me fshatrat përreth. Pyetja ime ka të bëjë me gjendjen e ujësjellësit në këtë zonë.”

Përgjigja e Kryetarit

“Faleminderit shumë.

Sa i përket ujësjellësit në Bashkësinë Lokale të Gllarevës, projekti ka avancuar dukshëm dhe vendosja e gypave është realizuar në shumicën e fshatrave. Megjithatë, ka mbetur një segment që kërkon trajtim dhe kordinim me kompaninë rajonale të ujësjellësit, e cila menaxhon sistemin e furnizimit me ujë në komunën tonë.

Gjatë viteve të ardhshme do të vazhdojmë me zgjerimin e rrjetit dhe finalizimin e projektit në këtë zonë.”

Mbyllja e Takimit

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari pyeti nëse kishte edhe pjesëmarrës të tjerë që dëshironin të paraqisnin kërkesa apo rekomandime.

Meqenëse nuk pati paraqitje të tjera, ai e shpalli të mbyllur takimin dhe falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre.

Gjithashtu, u theksua se të gjitha komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e paraqitura gjatë dëgjimit publik janë regjistruar në procesverbal dhe do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Ky raport më pas do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku qytetarët do të kenë mundësi të shohin statusin dhe përgjigjet për kërkesat e tyre.

“Mirëmbetshi!”

Takimi u mbyll në ora 11:30

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	17
Totali	17

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu




The image shows a handwritten signature in black ink over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVES' at the top, 'KOMUNA E KLINE' in the center, and 'OPSTINA KLINE' at the bottom. In the center of the stamp is a coat of arms featuring a shield with a sun, a star, and a figure, flanked by two olive branches.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06 - 17.376/26
Klinë, datë: 02.06.2026 27.06.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i dyt publik për kornizën afatmesme buxhetore të viteve 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave Poterq, Drenoc, Dugajev të komunës së Klinës, me, datë 02.06.2026, ora 17:00, Oda e Fshatit

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 16/06/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i kornizes afatmesme buxhetore i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft korniza afatmesme buxhetore edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuara.

Takimi ka nisur në ora 17:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 17 persona, prej të cilëve, 17 burra.

Shtojca 2 – Fotografi nga dëgjim i dytë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me kryetaret e kshillav lokal e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj.

Fjala hyrëse e Kryetarit

“Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës, të nderuar qytetarë të fshatrave Poterq, Drenoc dhe Dugajevë, përfaqësues të institucioneve,

Kam kënaqësinë që sot para jush të prezantoj Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2027–2029, një dokument strategjik që përcakton drejtimin e zhvillimit ekonomik, social dhe infrastrukturor të komunës sonë për tri vitet e ardhshme.

Qëllimi ynë kryesor mbetet përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimi i qëndrueshëm i çdo pjese të territorit të Komunës së Klinës. Përmes kësaj kornize buxhetore kemi planifikuar investime të rëndësishme në infrastrukturën rrugore, arsimin, shëndetësinë, kulturën, sportin, bujqësinë, mbrojtjen e mjedisit dhe shërbimet publike.

Gjatë viteve 2027–2029 do të vazhdojmë investimet në asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve lokale, ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përmirësimin e ndriçimit publik, si dhe krijimin e hapësirave të reja rekreative për qytetarët tanë.

Vëmendje e veçantë do t’i kushtohet shkollave dhe institucioneve shëndetësore, duke investuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për nxënësit dhe qytetarët.

Po ashtu, do të mbështesim sektorin e bujqësisë dhe bizneset lokale përmes subvencioneve dhe projekteve zhvillimore, me synim fuqizimin e ekonomisë lokale.

Ky dokument është rezultat i planifikimit të kujdesshëm financiar dhe i nevojave të identifikuara në bashkëpunim me qytetarët dhe grupet e interesit. Prandaj, ftoj të gjithë qytetarët që të japin kontributin e tyre përmes sugjerimeve dhe komenteve, në mënyrë që prioritetet tona zhvillimore të reflektojnë sa më mirë nevojat e komunitetit.

Së bashku do të vazhdojmë të ndërtojmë një komunë më të zhvilluar, më moderne dhe më të mirë për të gjithë qytetarët e Klinës.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj!”

Pas fjalimit, Kryetari iu drejtua qytetarëve:

“Urdhëroni për çdo kërkesë dhe çdo pyetje. Jam i hapur për ju dhe për çdo bashkëpunim.”

Diskutimet e pjesëmarrësve

Muharrem Musa, Poterq

“Përshëndetje Kryetar dhe ju të nderuar të pranishëm.

Kërkesa ime është që jazi afër shkollës të vazhdohet deri te ura e Poterqit, pasi vërshimet po na shkaktojnë vështirësi në jetën e përditshme.”

Përgjigjja e Kryetarit:

“Faleminderit shumë.

Do ta përfshijmë në projekt dhe do të mundohemi që gjatë viteve në vijim të vazhdojmë edhe pjesën tjetër të jazit.”

Ukë Manxholli, Poterq

“Pyetja ime është që te varrezat e dëshmorëve në fshatin Poterq të bëhet drenazhimi, sepse gjatë vërshimeve po shemben. Kërkesa tjetër është që këto varreza të rrethohen.”

Përgjigjja e Kryetarit:

“Faleminderit shumë, Ukë.

Pothuajse të gjitha rrethojat e varrezave në këtë zonë janë në planifikim dhe gjatë viteve 2027–2029 synojmë që të përfundojnë në të gjitha këto fshatra. Kërkesën për drenazh do ta përfshijmë gjithashtu në projektet tona.”

Ymer Ramaj, Poterq

“Përshëndetje Kryetar!

Kërkesa ime është ndërtimi i një kanali te podi i fshatit, pasi vërshimet po na shkaktojnë dëme.”

Përgjigjja e Kryetarit:

“Faleminderit shumë!

Plani ynë është që gjatë këtyre dy viteve të zgjerojmë kanalet dhe lumenjtë, si dhe të ndërhyjmë aty ku është e nevojshme. Kemi punuar shumë në këtë drejtim dhe kemi arritur të evidentojmë shumë probleme të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.”

Fazli Rama, Drenoc

“Përshëndetje të gjithëve.

Kam disa kërkesa:

1. Zgjidhjen e çështjes së ujësjellësit në fshatin tonë;
2. Shtrimin me zhavorr të rreth 1500 metrave rrugë fushore;
3. Ndërtimin e 30 metrave kanal me gypa të mbyllur.”

Përgjigjja e Kryetarit:

“Faleminderit shumë!

Sa i përket ujësjellësit në fshatin tuaj, për kit vit kam ndar 50 mijë euro për shtrirjen e usjellsit në vitet e ardhshme do të hartojmë një plan të veçantë për shtrirjen e tij ne gjithë territorin e fshatit Drenoc do të mundohemi që këto projekte dhe kërkesat tuaja t’i bëjmë të realizueshme, pavarësisht vështirësive financiare që po na shkaktohen nga obligimet e kontratës kolektive,

Ndërsa këtë vit do të shtrojmë rrugë fushore edhe në fshatin tuaj, si dhe në fshatra të tjera të Komunës së Klinës.”

Bedri Rama, Drenoc

“Pyetja ime është që në lagjen tonë kemi nevojë për rreth 2500 metra trotuar.”

Përgjigjja e Kryetarit:

“Sa i përket trotuarit, një pjesë e madhe e fshatrave tashmë kanë përfituar nga këto projekte. Pjesën tjetër e kemi në planet tona, në mënyrë që të mbulojmë këtë nevojë me trotuare dhe ndriçim publik.”

Shaqir Fejza, Drenoc

“I nderuar Kryetar, të nderuar të pranishëm.

Kam dy kërkesa:

-Ndërtimin e parkut të fshatit te lapidari;

-Rreth 30 metra kanalizim.”

Përgjigja e Kryetarit:

“Parkun te lapidari e kemi planifikuar për vitin e ardhshëm, ndërsa gjatë dy viteve të ardhshme do të vazhdojë shtrirja e kanalizimit në të gjitha fshatrat ku ende ka mbetur pa u përfunduar. Shumica e projekteve janë realizuar dhe pjesën e mbetur do ta përfundojmë.”

Mbyllja e Takimit

Kryetari i Komunës së Klinës pyeti nëse kishte pjesëmarrës të tjerë që dëshironin të paraqisnin kërkesa apo rekomandime.

Meqenëse nuk pati diskutime të tjera, Kryetari e shpalli të mbyllur takimin dhe falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e tyre.

“Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara në këtë procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raportin do ta gjeni të publikuar në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili prej jush do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!”

Takimi u mbyll në ora 17:40

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	17
Totali	17

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

Nr. 06-17378/26

Klinë, datë: 02.06.2026 27.06.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i trët publik për kornizen afatmesme buxhetore te vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave Grabanic, Bokshiq, Dollovë, Qeskov dhe Këpuz te komunës së Klinës, me, datë 02.06.2026, ora 18:00, në shkollen fillore "Azem Bejta" Grabnic.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 16/06/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.


Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i kornizes afatmesme buxhetore i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft korniza afatmesme buxhetore edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuara.

Takimi ka nisur në ora 18:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 15 persona, prej të cilëve, 15 burra.

Shtojca 3 – Fotografi nga dëgjim i tretë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me kryetarët e kshillav lokal e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:

"Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës,

Të nderuar banorë të fshatrave Grabanic, Bokshiq, Dollov, Këpuz dhe Qeskov, përfaqësues të institucioneve,

Kam kënaqësinë që sot para jush të prezantoj Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2027–2029, një dokument strategjik që përcakton drejtimin e zhvillimit ekonomik, social dhe infrastrukturor të komunës sonë për tri vitet e ardhshme.

Qëllimi ynë kryesor mbetet përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimi i qëndrueshëm i çdo pjese të territorit të Komunës së Klinës. Përmes kësaj kornize buxhetore kemi planifikuar investime të rëndësishme në infrastrukturën rrugore, arsimin, shëndetësinë, kulturën, sportin, bujqësinë, mbrojtjen e mjedisit dhe shërbimet publike.

Gjatë viteve 2027–2029 do të vazhdojmë investimet në asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve lokale, ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përmirësimin e ndriçimit publik, si dhe krijimin e hapësirave të reja rekreative për qytetarët tanë.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shkollave dhe institucioneve shëndetësore, duke investuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për nxënësit dhe qytetarët.

Po ashtu, do të mbështesim sektorin e bujqësisë dhe bizneset lokale përmes subvencioneve dhe projekteve zhvillimore, me synim fuqizimin e ekonomisë lokale.

Ky dokument është rezultat i planifikimit të kujdesshëm financiar dhe i nevojave të identifikuara në bashkëpunim me qytetarët dhe grupet e interesit. Prandaj, ftoj të gjithë qytetarët që të japin kontributin e tyre përmes sugjerimeve dhe komenteve, në mënyrë që prioritetet tona zhvillimore të reflektojnë sa më mirë nevojat e komunitetit.

Së bashku do të vazhdojmë të ndërtojmë një komunë më të zhvilluar, më moderne dhe më të mirë për të gjithë qytetarët e Klinës.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj!"

Pas fjalimit, Kryetari iu drejtua qytetarëve:

"Urdhëroni për çdo kërkesë apo pyetje. Jam i hapur për ju dhe për çdo bashkëpunim."

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 18:30

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	15
Totali	15

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

Nr. *01* *17386/26*

Klinë, datë: 04.06.2026 *27.06.2026*

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i katërt publik për kornizën afatmesme buxhetore të viteve 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave Zajm, Gremnik, Deiq, Dollc dhe Dresnik të komunës së Klinës, me, datë 04.06.2026, ora 17:00, shkolla fillore "Motrat Qirazi" Zajm.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 16/06/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimit në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.



Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i kornizes afatmesme buxhetore i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft korniza afatmesme buxhetore edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuara.

Takimi ka nisur në ora 17:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 11 persona, prej të cilëve, 11 burra.

Shtojca 4 – Fotografi nga dëgjim i katërt për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me kryetaret e kshillav lokal e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:

"Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës,

Të nderuar banorë të fshatrave Zajm, Gremnik, Deiq, Dolic dhe Dresnik, përfaqësues të institucioneve,

Kam kënaqësinë që sot para jush të prezantoj Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2027–2029, një dokument strategjik që përcakton drejtimin e zhvillimit ekonomik, social dhe infrastrukturor të komunës sonë për tri vitet e ardhshme.

Qëllimi ynë kryesor mbetet përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimi i qëndrueshëm i çdo pjese të territorit të Komunës së Klinës. Përmes kësaj kornize buxhetore kemi planifikuar investime të rëndësishme në infrastrukturën rrugore, arsimin, shëndetësinë, kulturën, sportin, bujqësinë, mbrojtjen e mjedisit dhe shërbimet publike.

Gjatë viteve 2027–2029 do të vazhdojmë investimet në asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve lokale, ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përmirësimin e ndriçimit publik, si dhe krijimin e hapësirave të reja rekreative për qytetarët tanë.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shkollave dhe institucioneve shëndetësore, duke investuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për nxënësit dhe qytetarët.

Po ashtu, do të mbështesim sektorin e bujqësisë dhe bizneset lokale përmes subvencioneve dhe projekteve zhvillimore, me synim fuqizimin e ekonomisë lokale.

Ky dokument është rezultat i planifikimit të kujdesshëm financiar dhe i nevojave të identifikuara në bashkëpunim me qytetarët dhe grupet e interesit. Prandaj, ftoj të gjithë qytetarët që të japin kontributin e tyre përmes sugjerimeve dhe komenteve, në mënyrë që prioritetet tona zhvillimore të reflektojnë sa më mirë nevojat e komunitetit.

Së bashku do të vazhdojmë të ndërtojmë një komunë më të zhvilluar, më moderne dhe më të mirë për të gjithë qytetarët e Klinës.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj!"

Pas fjalimit, Kryetari iu drejtua qytetarëve:

"Urdhëroni për çdo kërkesë apo pyetje. Jam i hapur për ju dhe për çdo bashkëpunim."

Xhafer Gashi (Zajm):

"Përshëndetje, Kryetar.

Kërkesa ime është që të na shtrohet me asfalt një rrugicë në fshatin tonë."

Përgjigja e Kryetarit:

"Faleminderit shumë.

Këtë kërkesë do ta shënojmë në procesverbal dhe, brenda tri viteve të ardhshme, synojmë që të shtrojmë të gjitha rrugët që kanë mbetur pa asfalt."

Lek Frroku (Dollc):

"Kryetar, kam një kërkesë për fshatin tim. Kemi probleme me rrjetin elektrik, me shtylla të vjetra dhe tela të energjisë elektrike që pothuajse prekin tokën, gjë që paraqet rrezik për banorët. Gjithashtu, kemi nevojë për sistem kanalizimi."

Përgjigja e Kryetarit:

"Faleminderit shumë, z. Frroku.

Sa i përket rrjetit elektrik, komuna nuk është kompetente për menaxhimin e tij. Megjithatë, jam takuar disa herë me përfaqësuesit e KEDS-it dhe kam kërkuar ndërhyrje edhe për fshatin tuaj.

Ju sugjeroj që si fshat t'i drejtoheni KEDS-it me një kërkesë zyrtare dhe një kopje të ma përcillni edhe mua. Do të angazhohem që këtë çështje ta trajtojmë me prioritet.

Sa i përket kanalizimit, gjatë tri viteve të ardhshme parashohim që të përfundojmë rrjetin e kanalizimit në tërë territorin e komunës."

Kristjan Hajdari (Deiq):

"Përshëndetje, Kryetar.

Kërkesa ime është që të parashihet në buxhet zgjerimi i kanalit që lidhet me lumin Drin, pasi gjatë vërshimeve uji po na dëmton tokat bujqësore dhe pronat familjare."

Përgjigja e Kryetarit:

"Faleminderit shumë.

Plani ynë është që gjatë këtyre tri viteve të zgjerojmë kanalet dhe shtretërit e lumenjve aty ku është e nevojshme. Kemi realizuar një numër të konsiderueshëm ndërhyrjesh dhe kemi evidentuar shumë probleme të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore."

Tun Dedaj (Deiq):

"Përshëndetje, Kryetar dhe të pranishëm.

Kam vetëm një kërkesë: a ka ndonjë plan për rrethimin e varrezave të fshatit tonë?"

Përgjigja e Kryetarit:

"Faleminderit shumë, z. Dedaj.

Po planifikojmë që brenda një periudhe trevjeçare të përfundojmë rrethimin e varrezave në të gjitha fshatrat ku ky investim ende nuk është realizuar."

Tom Marku (Deiq):

"Pyetja ime është: a do të shtrohet rruga kryesore Deiq-Zajm, nga Ura e Haxhisë deri te pompa Kastrati?"

Përgjigja e Kryetarit:

"Faleminderit shumë.

Kemi planifikuar një projekt të ardhshëm për asfaltimin e plotë të rrugës Deiq-Zajm. Gjithashtu, punimet për trotuarin kanë avancuar deri në gjysmën e gjatësisë së tij dhe parashohim që së shpejti ta përfundojmë tërësisht.

Pas asfaltimit të rrugës do të bëhet edhe sinjalizimi horizontal dhe vertikal, përfshirë vijat e bardha, shenjat e komunikacionit dhe vendkalimet për këmbësorë."

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.


Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 17:40

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	11
Totali	11

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

Nr. 06 - 17389/26

Klinë, datë: 04.06.2026 27.06.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i pestë publik për kornizen afatmesme buxhetore te vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave Shtupel, Kerrnicë, Binxh, Grabc dhe Komitetin jo shunic te komunës së Klinës, me, datë 04.06.2026, ora 18:00, shkolla fillore "Avni Zhabota" Shtupel.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 16/06/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i kornizes afatmesme buxhetore i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft korniza afatmesme buxhetore edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuara.

Takimi ka nisur në ora 18:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 20 persona, prej të cilëve, 17 burra,dhe 3 gra

Shtojca 5 – Fotografi nga dëgjim i pestë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me kryetaret e kshillav lokal e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:

"Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës,

Të nderuar banorë të fshatrave Shtupel, Kerrnicë, Binxh, Grabc dhe komuniteti jo shumic, përfaqësues të institucioneve,

Kam kënaqësinë që sot para jush të prezantoj Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2027–2029, një dokument strategjik që përcakton drejtimin e zhvillimit ekonomik, social dhe infrastrukturor të komunës sonë për tri vitet e ardhshme.

Qëllimi ynë kryesor mbetet përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimi i qëndrueshëm i çdo pjese të territorit të Komunës së Klinës. Përmes kësaj kornize buxhetore kemi planifikuar investime të rëndësishme në infrastrukturën rrugore, arsimin, shëndetësinë, kulturën, sportin, bujqësinë, mbrojtjen e mjedisit dhe shërbimet publike.

Gjatë viteve 2027–2029 do të vazhdojmë investimet në asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve lokale, ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përmirësimin e ndriçimit publik, si dhe krijimin e hapësirave të reja rekreative për qytetarët tanë.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shkollave dhe institucioneve shëndetësore, duke investuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për nxënësit dhe qytetarët.

Po ashtu, do të mbështesim sektorin e bujqësisë dhe bizneset lokale përmes subvencioneve dhe projekteve zhvillimore, me synim fuqizimin e ekonomisë lokale.

Ky dokument është rezultat i planifikimit të kujdesshëm financiar dhe i nevojave të identifikuara në bashkëpunim me qytetarët dhe grupet e interesit. Prandaj, ftoj të gjithë qytetarët që të japin kontributin e tyre përmes sugjerimeve dhe komenteve, në mënyrë që prioritetet tona zhvillimore të reflektojnë sa më mirë nevojat e komunitetit.

Së bashku do të vazhdojmë të ndërtojmë një komunë më të zhvilluar, më moderne dhe më të mirë për të gjithë qytetarët e Klinës.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj!"

Pas fjalimit, Kryetari iu drejtua qytetarëve:

"Urdhëroni për çdo kërkesë apo pyetje. Jam i hapur për ju dhe për çdo bashkëpunim."

Muhamet Dauti (Shtupel):

Përshëndetje, Kryetar.

Kërkesa ime është që disa rrugë në fshatin tonë kanë mbetur pa emërtime.

Përgjigjja e Kryetarit:

Faleminderit shumë.

Kemi themeluar Komisionin për Emërtimin e Rrugëve. Aty duhet t'i adresoni kërkesat tuaja. Komisioni i shqyrton dhe i dërgon në Ministrinë e Pushtetit Lokal për aprovim.

Kujtim Temaj (Shtupel):

Kërkesa ime për ju është që kemi një rrugicë të shkurtër, rreth 50 metra, e cila ka nevojë të shtrohet me asfalt.

Përgjigjja e Kryetarit:

Faleminderit shumë.

Do ta shqyrtojmë mundësinë që, në afatin më të afërt, t'i përfundojmë këto rrugë, apo më mirë të themi rrugica, që kanë mbetur pa u shtruar, brenda një periudhe trevjeçare.

Magjun Fejzullahu (Shtupel):

Përshëndetje, Kryetar.

Kërkesa ime është që të na shtrohen rreth 5,000 metra rrugë fushore me zhavor, pasi kemi vështirësi në punimin e tokave. Gjithashtu, kemi një rrugë në fshatin tonë që është bërë e pakalueshme, pasi dy vetura kanë vështirësi të kalojnë njëra pranë tjetrës për shkak të degëve dhe barishtave që ka dalë përgjatë saj.

Përgjigjja e Kryetarit:

Faleminderit shumë.

Sa i përket rrugëve fushore dhe pastrimit apo zgjerimit të rrugëve nga degët dhe pengesat e tjera, kemi planifikuar dhe kemi arritur një marrëveshje me kompaninë e pastrimit KRM Ambienti. Ne do të blejmë një kamion, ndërsa KRM Ambienti do të blejë një bager me të gjitha pajisjet përcjellëse, përfshirë edhe prerësen e degëve që pengojnë qarkullimin përgjatë rrugëve më pas, neve do të na mbetet vetëm të sigurojmë zhavorin për të shtruar rrugët fushore. Aty ku ka kërkesa të nevojshme, do të përpiqemi t'ju ndihmojmë dhe të jemi në dispozicion për çdo shërbim ndaj qytetarëve të Komunës së Klinës.

Faruk Dauti (Shtupel):

Përshëndetje, Kryetar dhe të pranishëm.

Kam vetëm një kërkesë: të vendosen disa pengesa të shpejtësisë (policë të shtrirë prej gome) në asfalt, për shkak të shpejtësisë së automjeteve që paraqesin rrezik për banorët e fshatit.

Përgjigjja e Kryetarit:

Faleminderit shumë.

Sa i përket pengesave të shpejtësisë prej gome, kjo është një kërkesë e realizueshme dhe nuk paraqet ndonjë problem të madh do të gjejmë mundësinë për vendosjen e tyre.

Samir Demaj (Shtupel):

Kryetar, a ka ndonjë projekt për furnizimin me ujë të pijshëm në fshatin tonë?

Përgjigjja e Kryetarit:

Faleminderit shumë.

Kemi menduar të ndërtojmë një fabrikë të re të ujit me kapacitet prej 300 litrave në sekondë, ndërsa aktualisht kapaciteti është 100 litra në sekondë.

Megjithëse këtë vit po përballemi me një krizë financiare, pasi përmbaruesit, për shkak të kontratës kolektive, na kanë marrë një pjesë të konsiderueshme të fondeve të investimeve kapitale, ne nuk do të ndalemi së punuari për t'ju shërbyer qytetarëve.

Do të kërkojmë mbështetje edhe nga Ministria e Pushtetit Lokal, si dhe nga grantet apo donatorët e ndryshëm, për ta realizuar këtë project qëllimi ynë është rritja e kapaciteteve të furnizimit me ujë të pijshëm, në mënyrë që i gjithë territori i Klinës të ketë furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijshëm.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.


Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 19:00

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	3
Burra	17
Totali	20

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdu





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06-17373/26

Klinë, datë: 05.06.2026 / 21.06.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i gjashtë publik për kornizen afatmesme buxhetore te vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave Jashanic, Pogradj, Siqev, Ujemir, Gjurgjevik i madh, Doberdol, Jelloc, Resnik dhe Dush i vogel te komunës së Klinës, me, datë 05.06.2026, ora 17:00, shkolla fillore "Tre Dëshmorët" Jashanic.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 16/06/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.



Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i kornizes afatmesme buxhetore i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft korniza afatmesme buxhetore edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 17:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 20 persona, prej të cilëve, 18 burra,dhe 2 gra

Shtojca 6 – Fotografi nga dëgjim i gjashtë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me kryetaret e kshillav lokal e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:

"Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës,

Të nderuar banorë të fshatrave Jashanic, Pogragj, Resnik, Siqeve, Gjurgjevik I madh, Ujmir, Doberdol Jelloc, dhe Dush I vogel, përfaqësues të institucioneve,

Kam kënaqësinë që sot para jush të prezantoj Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2027–2029, një dokument strategjik që përcakton drejtimin e zhvillimit ekonomik, social dhe infrastrukturor të komunës sonë për tri vitet e ardhshme.

Qëllimi ynë kryesor mbetet përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimi i qëndrueshëm i çdo pjese të territorit të Komunës së Klinës. Përmes kësaj kornize buxhetore kemi planifikuar investime të rëndësishme në infrastrukturën rrugore, arsimin, shëndetësinë, kulturën, sportin, bujqësinë, mbrojtjen e mjedisit dhe shërbimet publike.

Gjatë viteve 2027–2029 do të vazhdojmë investimet në asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve lokale, ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përmirësimin e ndriçimit publik, si dhe krijimin e hapësirave të reja rekreative për qytetarët tanë.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shkollave dhe institucioneve shëndetësore, duke investuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për nxënësit dhe qytetarët.

Po ashtu, do të mbështesim sektorin e bujqësisë dhe bizneset lokale përmes subvencioneve dhe projekteve zhvillimore, me synim fuqizimin e ekonomisë lokale.

Ky dokument është rezultat i planifikimit të kujdesshëm financiar dhe i nevojave të identifikuara në bashkëpunim me qytetarët dhe grupet e interesit. Prandaj, ftoj të gjithë qytetarët që të japin kontributin e tyre përmes sugjerimeve dhe komenteve, në mënyrë që prioritetet tona zhvillimore të reflektojnë sa më mirë nevojat e komunitetit.

Së bashku do të vazhdojmë të ndërtojmë një komunë më të zhvilluar, më moderne dhe më të mirë për të gjithë qytetarët e Klinës.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj!"

Pas fjalimit, Kryetari iu drejtua qytetarëve:

"Urdhëroni për çdo kërkesë apo pyetje. Jam i hapur për ju dhe për çdo bashkëpunim."

Aziz Bajraktari (Resnik):

Përshëndetje, Kryetar.

Kërkesa ime është për 70 metra kanalizim.

Përgjigjja e Kryetarit:

Faleminderit shumë.

Çdo kërkesë të juajën, të secilit qytetar, do ta trajtojmë me një kujdes të veçantë. Plani ynë është që në një periudhë brenda 2 viteve të ardhshme të mbulojmë tërë territorin e komunës me shtrirje të kanalizimeve.

Skender Desku (Jelloc):

Pyetja ime, Kryetar, për ju është se kemi nevojë për 100 metra kanalizim.

Përgjigjja e Kryetarit:

Faleminderit shumë.

Siç e ceka edhe te Azizi, këto pjesë të vogla të kanalizimeve që kanë mbetur pa u përfunduar do t'i qesim në projekt-buxhet në 2 vitet e ardhshme që t'i përfundojmë dhe të jenë të kompletuara të gjitha fshatrat. Vitin e kaluar kemi shtrirë rrjet kanalizimi diku 3000 metra për një vit.

Tahir Berisha (Gjurgjevik i Madh):

Përshëndetje, Kryetar.

Rruga kryesore është mbuluar prej lisave dhe degëve që na vështirësojnë kalimin ose shpërndarjen me dy vetura, dhe kërkesa tjetër është se kemi diku 500 metra rrugë fushore që na nevojiten me i shtruar me zhavor.

Përgjigjja e Kryetarit:

Faleminderit shumë.

Sa i përket rrugëve fushore dhe pastrimit apo zgjerimit të rrugëve nga degët dhe pengesat e tjera, kemi planifikuar dhe kemi arritur një marrëveshje me KRM Ambienti. Ne do të blejmë një kamion, ndërsa KRM Ambienti do të blejë një bager me të gjitha pajisjet përcjellëse, përfshirë edhe prerësen e degëve që pengojnë qarkullimin përgjatë rrugëve. Më pas, neve do të na mbetet vetëm të sigurojmë zhavorin për të shtruar rrugët fushore. Aty ku ka kërkesa të nevojshme, do të përpiqemi t'ju ndihmojmë dhe të jemi në dispozicion për çdo shërbim ndaj qytetarëve të Komunës së Klinës.

Mark Toplanaj (Pograxh):

Përshëndetje, Kryetar dhe të pranishëm.

Deshta t'i ndaj disa shqetësime me ju. Kur pati vërshime, më janë dëmtuar diku 2 hektarë tokë bujqësore dhe a ka ndonjë përgjigje për këtë problem. E dyta është se kemi problem me telat e rrymës edhe me shtyllat elektrike në fshatin tonë. Kam edhe një kërkesë për 80 metra kanalizim.

Përgjigjja e Kryetarit:

Faleminderit shumë, Mark.

Ne si komunë kemi themeluar komisionin për vlerësimin e dëmeve që janë bërë nga vërshimet dhe Qeveria ka marrë përsipër që t'i kompensojë të gjitha dëmet e shkaktuara nga vërshimet. Ne vetëm kemi pasur obligim ta formojmë komisionin për vlerësimin e tyre dhe t'ia dërgojmë raportin në Qeveri, e ata t'i kompensojnë. Sa i përket telave të rrymës dhe shtyllave elektrike, ne si komunë nuk jemi kompetentë, KEDS është përgjegjës, mirëpo ju mundeni ta bëni një kërkesë në KEDS dhe atë kërkesë ma dërgoni edhe mua. Unë do t'i kontaktoj dhe do të mundohemi ta gjejmë një zgjidhje. E për kanalizim do t'i qesim në projekt-buxhet të gjitha këto që kanë mbetur pa u kryer, që t'i përfundojmë në një afat sa më të shkurtër.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 18:00

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	3
Burra	17
Totali	20

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06 - 17376/26

Klinë, datë: 05.06.2026 / 22.06.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i shtatë publik për kornizën afatmesme buxhetore të viteve 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave Gllarevë, Sferkë, Ceravik, Volljakë, Zabërgj, Përqev, Stapanic, dhe Rixhevë të komunës së Klinës, me datë 05.06.2026, ora 18:00, shkolla fillore "Dëshmoret e Qëndresës.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 16/06/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimit në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.


Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i kornizes afatmesme buxhetore i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft korniza afatmesme buxhetore edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 18:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 17 persona, prej të cilëve, 17 burra,

Shtojca 7 – Fotografi nga dëgjim i shtatë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me kryetaret e kshillav lokal e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:

"Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës,

Të nderuar banorë të fshatrave Gllarvë, Rixhevë, Stapanic, Caravikë, Perqevë, Zabergjë, Volljak dhe Sferkë, përfaqësues të institucioneve,

Kam kënaqësinë që sot para jush të prezantoj Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2027–2029, një dokument strategjik që përcakton drejtimin e zhvillimit ekonomik, social dhe infrastrukturor të komunës sonë për tri vitet e ardhshme.

Qëllimi ynë kryesor mbetet përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimi i qëndrueshëm i çdo pjese të territorit të Komunës së Klinës. Përmes kësaj kornize buxhetore kemi planifikuar investime të rëndësishme në infrastrukturën rrugore, arsimin, shëndetësinë, kulturën, sportin, bujqësinë, mbrojtjen e mjedisit dhe shërbimet publike.

Gjatë viteve 2027–2029 do të vazhdojmë investimet në asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve lokale, ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përmirësimin e ndriçimit publik, si dhe krijimin e hapësirave të reja rekreative për qytetarët tanë.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shkollave dhe institucioneve shëndetësore, duke investuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për nxënësit dhe qytetarët.

Po ashtu, do të mbështesim sektorin e bujqësisë dhe bizneset lokale përmes subvencioneve dhe projekteve zhvillimore, me synim fuqizimin e ekonomisë lokale.

Ky dokument është rezultat i planifikimit të kujdesshëm financiar dhe i nevojave të identifikuara në bashkëpunim me qytetarët dhe grupet e interesit. Prandaj, ftoj të gjithë qytetarët që të japin kontributin e tyre përmes sugjerimeve dhe komenteve, në mënyrë që prioritetet tona zhvillimore të reflektojnë sa më mirë nevojat e komunitetit.

Së bashku do të vazhdojmë të ndërtojmë një komunë më të zhvilluar, më moderne dhe më të mirë për të gjithë qytetarët e Klinës.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj!"

Pas fjalimit, Kryetari iu drejtua qytetarëve:

"Urdhëroni për çdo kërkesë apo pyetje. Jam i hapur për ju dhe për çdo bashkëpunim."

Amrush Hasanaj (Gllarevë)

Pyetje:

Përshëndetje, Kryetar.

Kërkesa ime është që të planifikoni në projektet komunale ndërtimin e një parku në fshatin tonë.

Përgjigja e Kryetarit:

Faleminderit shumë për kërkesën. Çdo kërkesë e qytetarëve do të trajtohet me kujdes të veçantë. Sa i përket parkut në fshatin Gllarevë, ai ka qenë i planifikuar për këtë vit. Mirëpo, për shkak të obligimeve financiare dhe fondeve të marra nga përmbaruesi, realizimi i projektit është shtyrë. Synimi ynë është që parku të planifikohet dhe të ndërtohet brenda tre viteve të ardhshme.

Pajazit Veselaj (Gllarevë)

Pyetje:

Kryetar, jemi dy familje që ende nuk kemi të përfunduar rrjetin e kanalizimit. Bëhet fjalë për rreth 100 metra kanalizim. Nuk është urgjente, por dëshirojmë të dimë nëse do të përfshihet në projektet e ardhshme dhe nëse mund të përfundohet brenda tre viteve të ardhshme.

Përgjigja e Kryetarit:

Faleminderit. Pjesët e mbetura të kanalizimeve që ende nuk janë përfunduar do të përfshihen në projekt-buxhet gjatë dy viteve të ardhshme, me qëllim që të kompletohet infrastruktura e kanalizimit në të gjitha fshatrat.

Asllan Haxhaj (Gllarevë)

Pyetje:

Kryetar, si banor i fshatit Gllarevë kam tri kërkesa:

Në lagjen tonë janë vendosur shtyllat elektrike, por kabllot ende nuk janë shtrirë, pavarësisht kërkesave të shumta drejtuar KEDS-it.

Te oborri i Januz Haxhajt ndodhet një shtyllë elektrike e vendosur në hyrje të oborrit, e cila nuk është larguar nga KEDS-i.

Në lagjen e Hasanjve deri te Haxhajt, telat e rrymës prekin tokën dhe shtyllat janë në gjendje të dobët.

Përgjigja e Kryetarit:

Sa i përket telave të rrymës dhe shtyllave elektrike, komuna nuk është institucioni kompetent; përgjegjës për këtë çështje është KEDS-i. Ju sugjeroj të bëni një kërkesë zyrtare në KEDS dhe një kopje të ma dërgoni edhe mua. Do t'i kontaktoj përfaqësuesit e tyre dhe do të përpiqemi të gjejmë një zgjidhje. Ndërsa sa i përket kanalizimit, të gjitha pjesët e mbetura do të përfshihen në projekt-buxhet, në mënyrë që të përfundojnë sa më shpejt.

Haki Morina (Rixhevë)

Pyetje:

Përsëndetje, Kryetar dhe të pranishëm.

Kam një kërkesë për shtrimin me zhavorr të një rruge fushore me gjatësi rreth 1,000 metra.

Përgjigjja e Kryetarit:

Do ta shqyrtojmë këtë kërkesë, edhe pse kemi pranuar disa kërkesa të ngjashme gjatë dëgjimeve të tjera publike. Plani ynë është që gjatë vitit të ardhshëm të shtrojmë disa rrugë fushore me zhavorr, ndër të cilat synojmë të përfshihet edhe rruga që ju keni kërkuar.

Fadil Bashota (Cerovikë)

Pyetje:

Përsëndetje, Kryetar.

Kam disa kërkesa që dëshiroj t'i paraqes dhe shpresoj që të përfshihen në projektet komunale:

Ndërtimi i trotuarit në fshatin Cerovikë, Vendosi e ndriçimit publik, pastrimi i dy deponive ilegale të mbeturinave, Shtrimi me zhavorr i rreth 1,500 metrave rrugë fushore,

Angazhimi i një mësuesi mbështetës për tre nxënës me aftësi të kufizuara që vijojnë mësimin në shkollën e fshatit, ndërtimi i një parku për banorët e fshatit.

Përgjigjja e Kryetarit

Faleminderit Fadil, faleminderit për pjesëmarrjen dhe për kërkesat e paraqitura.

Të gjitha kërkesat që keni adresuar do të shqyrtohen me kujdes dhe do të merren parasysh gjatë hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe planifikimit të projekteve për vitet në vijim.

Sa i përket ndërtimit të trotuarit, vendosjes së ndriçimit publik, pastrimit të deponive ilegale të mbeturinave, si dhe shtrimit me zhavorr të rrugëve fushore, këto kërkesa do të vlerësohen në bazë të prioriteteve, nevojave të komunitetit dhe mundësive buxhetore të komunës.

Lidhur me kërkesën për angazhimin e një mësuesi mbështetës për nxënësit me aftësi të kufizuara, komuna do ta adresojë këtë çështje në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të arsimit, me qëllim që të sigurohet mbështetja e nevojshme për këta nxënës.

Ndërsa sa i përket ndërtimit të një parku për banorët e fshatit, kjo kërkesë do të përfshihet në planifikimet afatmesme dhe do të trajtohet në përputhje me prioritetet zhvillimore dhe kapacitetet financiare të komunës. Ju falënderojmë për angazhimin dhe kontributin tuaj në identifikimin e nevojave të komunitetit. Synimi ynë mbetet që, përmes planifikimit të kujdesshëm dhe menaxhimit të përgjegjshëm të buxhetit, të realizojmë sa më shumë projekte në interes të qytetarëve.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.


Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 19:00

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	17
Totali	17

Procesmbajtësi
Egzon Sejdiu





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06-17382/26
Klinë, datë: 10.06.2026 / 22.06.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i tetë publik për kornizen afatmesme buxhetore te vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e komunës së Klinës, me, datë 10.06.2026, ora 16:00, Salla e koferncave kati i II Komuna e Klinës

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 16/06/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimit në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i kornizes afatmesme buxhetore i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft korniza afatmesme buxhetore edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 16:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 4 persona, prej të cilëve, 3 burra, 1 grua

Shtojca 8 – Fotografi nga dëgjim i tetë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me kryetaret e kshillav lokal e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:

FJALIMI I KRYETARIT NË DËGJIMIN E 8-TË PUBLIK PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2027–2029, KUSHTUAR TË RINJVE DHE GRAVE

Të nderuara gra,të nderuar të rinj,të respektuar pjesëmarrës,zonja dhe zotërinj,

Ju përshëndes dhe ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë dëgjim publik, i cili është i teti me radhë në kuadër të procesit të konsultimeve për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027–2029.

Sot kemi zgjedhur që këtë takim t’ua kushtojmë dy kategorive shumë të rëndësishme të shoqërisë sonë: të rinjve dhe grave. Kjo sepse zhvillimi i një komune të suksesshme nuk mund të paramendohet pa pjesëmarrjen aktive, kontributin dhe fuqizimin e tyre në jetën publike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

Korniza Afatmesme Buxhetore nuk është vetëm një dokument financiar. Ajo është një planifikim strategjik që përcakton prioritetet e komunës sonë për tre vitet e ardhshme. Për këtë arsye, është me rëndësi të veçantë që zëri juaj të dëgjohej dhe nevojat tuaja të reflektohen në projektet dhe politikat që do të ndërmarrim.

Të rinjtë përbëjnë potencialin më të madh të komunës sonë. Ne dëshirojmë të dëgjojmë idetë, kërkesat dhe propozimet tuaja për investime në arsim, sport, kulturë, teknologji, inovacion, hapësira rekreative dhe programe që krijojnë mundësi për zhvillim personal dhe profesional.

Po ashtu, gratë kanë një rol të pazëvendësueshëm në familje, ekonomi dhe shoqëri. Prandaj, jemi të interesuar të dëgjojmë propozimet tuaja lidhur me fuqizimin ekonomik të grave, përmirësimin e qasjes në shërbime publike, mbështetjen për ndërmarrësitë e grave, si dhe projektet që kontribuojnë në barazi dhe përfshirje më të madhe në vendimmarrje.

Komuna jonë mbetet e përkushtuar që përmes planifikimit të kujdesshëm buxhetor të krijojë mundësi më të mira për të gjithë qytetarët, pa dallim. Çdo propozim i paraqitur gjatë këtij procesi do të shqyrtohet me seriozitet dhe do të vlerësohet në përputhje me interesin publik dhe mundësitë buxhetore.

Ju ftoj që gjatë këtij takimi të jeni aktivë, të paraqisni kërkesat, shqetësimet dhe idetë tuaja. Vetëm përmes dialogut dhe bashkëpunimit mund të ndërtojmë politika dhe projekte që i përgjigjen nevojave reale të komunitetit tonë.

Në fund, ju falënderoj për kohën, angazhimin dhe kontributin tuaj. Besoj se së bashku do të arrijmë të hartojmë një Kornizë Afatmesme Buxhetore që reflekton prioritetet dhe aspiratat e qytetarëve tanë për vitet 2027–2029.

Ju faleminderit!

A keni ndonjë ide, propozim apo kërkesë nga ana e të rinjve të komunës sonë, të cilat dëshironi t'i paraqisni për t'i shqyrtuar dhe, sipas mundësive, për t'i përfshirë në projektet dhe planifikimet tona në kuadër të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027–2029

Rajmond Nocaj

Përshëndetje, Kryetar dhe të pranishëm.

Kërkesa ime është që të na mundësohet një hapësirë apo lokal për studentët e Komunës së Klinës, ku të mund të zhvillojmë aktivitetet tona studentore. Kërkojmë që kjo hapësirë të jetë në dispozicion gjatë periudhës sezonale prej rreth tre muajsh, në mënyrë që të organizojmë takime, aktivitete edukative, kulturore dhe projekte të ndryshme në interes të studentëve, faleminderit.

Përgjigja e Kryetarit:

Faleminderit për kërkesën tuaj ne e vlerësojmë angazhimin dhe aktivitetin e studentëve të komunës sonë. Kjo kërkesë do të merret parasysh dhe do të angazhohemi që t'ju sigurojmë një hapësirë të përshtatshme, ku studentët e komunës të mund të takohen, të bashkëpunojnë dhe të zhvillojnë aktivitetet e tyre edukative, kulturore dhe rinore synimi ynë është që të krijojmë kushte sa më të mira për të rinjtë dhe të mbështesim iniciativat e tyre, në mënyrë që ata të kenë një vend të dedikuar për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme në interes të komunitetit.

Faleminderit për kontributin dhe idetë tuaja.

Gjatë bashkëbisedimit me të rinjtë dhe studentët, Kryetari theksoi se mbështetja për studentët mbetet një nga prioritetet e komunës.

Ai deklaroi se ka planifikuar të rrisë numrin e bursave për studentët e komunës, si dhe vlerën e tyre financiare, ashtu siç është vepruar edhe në vitet e kaluara. megjithatë, ai theksoi se realizimi i këtij synimi do të varet nga mundësitë buxhetore të komunës.

Kryetari sqaroi se komuna është përballur me vështirësi financiare si pasojë e obligimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, ku një pjesë e mjeteve financiare janë ekzekutuar përmes procedurave përmbarimore dhe janë marrë nga fondet e parapara për investime kapitale. Pavarësisht këtyre sfidave, ai u zotua se do të shqyrtojë të gjitha mundësitë për të vazhduar mbështetjen e studentëve dhe për të rritur përfitimet e tyre në të ardhmen.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 16:40

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	1
Burra	3
Totali	4

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06-17387/26
Klinë, datë: 10.06.2026 / 12.06.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i nëntë publik për kornizën afatmesme buxhetore të viteve 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave Zllakuqan, Berkovë, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë, Rudicë, Jagodë, Videjë Krushev e Madhe dhe Budisalc të komunës së Klinës, me datë 10.06.2026, ora 17:00, shkolla fillore "Atë Shtjefën Gjeqovi"

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 16/06/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.


Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i kornizes afatmesme buxhetore i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft korniza afatmesme buxhetore edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 17:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 13 persona, prej të cilëve, 13 burra,

Shtojca 9 – Fotografi nga dëgjim i nëntë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me kryetarët e kshillav lokal e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:

"Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës,

Të nderuar banorë të fshatrave
Zllakuqan, Berkovë, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranishiq, Stupë, Rudicë, Jagodë, Videjë, Krushevë e
madhe dhe Budisalc, përfaqësues të institucioneve,

Kam kënaqësinë që sot para jush të prezantoj Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën
2027–2029, një dokument strategjik që përcakton drejtimin e zhvillimit ekonomik, social dhe
infrastrukturor të komunës sonë për tri vitet e ardhshme.

Qëllimi ynë kryesor mbetet përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimi i qëndrueshëm
i çdo pjese të territorit të Komunës së Klinës. Përmes kësaj kornize buxhetore kemi planifikuar
investime të rëndësishme në infrastrukturën rrugore, arsimin, shëndetësinë, kulturën, sportin,
bujqësinë, mbrojtjen e mjedisit dhe shërbimet publike.

Gjatë viteve 2027–2029 do të vazhdojmë investimet në asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve lokale,
ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përmirësimin e ndriçimit publik,
si dhe krijimin e hapësirave të reja rekreative për qytetarët tanë.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shkollave dhe institucioneve shëndetësore, duke investuar në
përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për nxënësit dhe qytetarët.

Po ashtu, do të mbështesim sektorin e bujqësisë dhe bizneset lokale përmes subvencioneve dhe
projekteve zhvillimore, me synim fuqizimin e ekonomisë lokale.

Ky dokument është rezultat i planifikimit të kujdesshëm financiar dhe i nevojave të identifikuara në
bashkëpunim me qytetarët dhe grupet e interesit. Prandaj, ftoj të gjithë qytetarët që të japin
kontributin e tyre përmes sugjerimeve dhe komenteve, në mënyrë që prioritetet tona zhvillimore të
reflektojnë sa më mirë nevojat e komunitetit.

Së bashku do të vazhdojmë të ndërtojmë një komunë më të zhvilluar, më moderne dhe më të mirë
për të gjithë qytetarët e Klinës.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj!"

Pas fjalimit, Kryetari iu drejtua qytetarëve:

"Urdhëroni për çdo kërkesë apo pyetje. Jam i hapur për ju dhe për çdo bashkëpunim."

Frrok Tanushi (Berkovë)

Pyetja: Ujërat e zeza për fshatin Berkovë, ndriçimi publik dhe trotuari – a i keni në projekte?

Përgjigjja e Kryetarit:

Faleminderit për kërkesën tuaj. Çdo kërkesë e qytetarëve trajtohet me kujdes të veçantë. Sa i përket ujërave të zeza (kanalizimit) dhe ndriçimit publik, këto projekte janë paraparë në planifikimet tona për periudhën 2027–2029.

Mark Gojani (Budisalc)

Pyetja: Kryetar, kam disa kërkesa: ndërtimin e një ure, betonizimin e 1200 metrave kanal të ujitjes në Rudicë, një rrugë te varrezat e komuniteteve, 200 metra rrugë në Stup dhe 200 metra në Rudicë, trotuarin Budisalc–Rudicë, rrugë fushore me zhavorr dhe rregullimin e rrethojave te varrezat në Budisalc.

Përgjigjja e Kryetarit:

Faleminderit për kërkesat tuaja. Pjesët e mbetura të kanalizimit që ende nuk janë përfunduar do të përfshihen në projekt-buxhet gjatë dy viteve të ardhshme, me qëllim që infrastruktura e kanalizimit të kompletohet në të gjitha fshatrat.

Sa i përket trotuarit, një pjesë e tij tashmë ka përfunduar, ndërsa pjesa tjetër është në kontratë dhe pritet të realizohet gjatë vitit të ardhshëm.

Për rrugët me zhavorr, kemi planifikuar që brenda dy viteve të ardhshme të nënshkruajmë një kontratë të re, në mënyrë që të intervenojmë në zonat më prioritare. Për këtë, do të kërkojmë mundësi financimi përmes fondeve komunale ose donacioneve.

Simon Perlaska (Zllakuqan)

Pyetja: Na nevojiten 600 metra kanalizim në fshatin tonë. Gjithashtu, ka disa rrugë fushore të pakalueshme, të cilat po e vështirësojnë punën në bujqësi. A ka mundësi të shtrohen me zhavorr?

Përgjigjja e Kryetarit:

Faleminderit, Simon. Vazhdimi i kanalizimit dhe ndërtimi i trotuarit në Zllakuqan janë paraparë në projektet e vitit 2027.

Edhe në Leskoc kemi filluar projektin e kanalizimit, por për shkak të problemeve financiare dhe mjeteve të bllokuara nga përmbarimi, punimet kanë mbetur pezull. Megjithatë, do të gjejmë një zgjidhje financiare për vazhdimin e projektit.

Sa i përket rrugëve me zhavorr, jemi duke shqyrtuar mundësinë e lidhjes së një kontrate të re dhe do të përpiqemi të sigurojmë bashkëfinancim nga Qeveria ose përmes ndonjë donacioni.

Lush Ndrecaj (Krushevë e Madhe)

Pyetja: Kam tri kërkesa për fshatin tonë: rrethimin e varrezave, një kanal për ujitjen e tokave bujqësore dhe ndërtimin e trotuarit.

Përgjigja e Kryetarit:

Sa i përket fshatit Krushevë e Madhe, një pjesë e konsiderueshme e trotuarit tashmë është realizuar. Për pjesën e mbetur kemi kontratë të lidhur dhe synimi ynë është që ta vazhdojmë projektin. Megjithatë, për shkak të mjeteve financiare të bllokuara nga përmbarimi, ka pasur vonesa.

Me gjithë vullnetin dhe angazhimin tonë, do të përpiqemi të sigurojmë mjetet e nevojshme për ta kompletuar trotuarin në të gjithë fshatin, si dhe për të vendosur shtylla metalike për ndriçimin publik.

Për kanalet e ujitjes, kontrata tashmë është nënshkruar dhe jemi në fazën përfundimtare të procedurave. Kemi planifikuar disa kilometra kanal ujitës që do të shpërndahen në disa fshatra, përfshirë edhe Krushevën e Madhe.

Sa i përket rrethimit të varrezave, synimi ynë është që këto punime të përfundojnë brenda dy viteve të ardhshme.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 18:00

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	13
Totali	13

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

Nr. 06-17393/26

Klinë, datë: 12.06.2026 27.06.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i dhjetë publik për kornizen afatmesme buxhetore te vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e Komunës së Klinës, qytetit dhe lagjeve me, datë 12.06.2026, ora 10:00, Salla e Kuvendit Komuna Klinë.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 16/06/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimit në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.



Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i kornizes afatmesme buxhetore i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft korniza afatmesme buxhetore edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 10:00 të pranishëm ishin Nenkryetari i Komunës së Klinës, z. Fadil Gashi, Kryesuesi i Kuvendit Z. Enver Berisha si dhe drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 18 persona, prej të cilëve, 17 burra, dhe 1 grua.

Shtojca 10 – Fotografi nga dëgjim i dhjetë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me kryetaret e kshillav lokal e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryesuesi I Kuvendit Z.Enver Berisha"

Fjalimi i Kryesuesit të Kuvendit Komunal, z. Enver Berisha

Të nderuar pjesëmarrës,

Kam kënaqësinë ta hap këtë takim lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2027–2029.

Në fillim, dëshiroj ta përshëndes nënkryetarin e komunës, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit Komunal, si dhe të gjithë të pranishmit që kanë gjetur kohë të marrin pjesë në këtë takim.

Sot po zhvillojmë takimin e fundit publik në kuadër të procesit të hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027–2029, i cili njëherësh është takimi i dhjetë me radhë. Gjatë këtij procesi kemi pasur mundësinë të dëgjojmë kërkesat, propozimet dhe nevojat e qytetarëve, duke synuar që planifikimi buxhetor të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe në shërbim të interesit publik.

Korniza Afatmesme Buxhetore paraqet një dokument me rëndësi të veçantë për zhvillimin e komunës sonë, pasi përcakton prioritetet strategjike dhe orientimin e investimeve për periudhën trevjeçare. Përmes saj krijohen bazat për menaxhim të qëndrueshëm financiar, realizim të projekteve zhvillimore dhe përmirësim të shërbimeve për qytetarët.

Prandaj, kontributi dhe pjesëmarrja juaj në këtë proces janë të një rëndësie të madhe, sepse ndihmojnë që planifikimi buxhetor të reflektojë nevojat reale të komunitetit tonë.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe ju dëshiroj punë të mbarë në vazhdim të këtij takimi.

Faleminderit!

Më pas, Kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Enver Berisha, ia dha fjalën Nënkyetarit të Komunës, z. Fadil Gashi, për një prezantim të shkurtër të Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027–2029.

Nënkyetari fillimisht përshëndeti Kryesuesin e Kuvendit Komunal, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit, si dhe të gjithë të pranishmit në takim.

Gjatë prezantimit, ai paraqiti në mënyrë të përmbledhur pikat kryesore të Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027–2029, duke u ndalur te prioritetet kryesore zhvillimore, planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe projektet e parapara për periudhën e ardhshme.

Pas prezantimit, Nënkyetari iu drejtua qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë me fjalët: “Nëse dikush nga ju ka ndonjë pyetje, propozim apo kërkesë lidhur me Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore, ju lutem jeni të lirë t’i paraqisni ato.”

Pas kësaj u hap diskutimi me pjesëmarrësit.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj!"

Pas fjalimit, Nenkryetari iu drejtua qytetarëve:

"Urdhëroni për çdo kërkesë apo pyetje. Jam i hapur për ju dhe për çdo bashkëpunim."

Naim Musliu (Klinë)

Naim Musliu përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe theksoi se në këtë takim po merr pjesë në cilësinë e qytetarit dhe jo si anëtar i Kuvendit Komunal të Klinës.

Ai kërkoi nga Komuna që të planifikojë dhe të hartojë një projekt afatgjatë për furnizimin me ujë të pijshëm, në mënyrë që qytetarët të mos përballen me probleme të vazhdueshme në këtë shërbim jetik.

Po ashtu, ai propozoi që disa nga projektet e parapara për periudhën 2027–2029 të shqyrtohen për mundësinë e realizimit më të hershëm, me qëllim që të përfundojnë sa më shpejt dhe të jenë në shërbim të qytetarëve.

Lidhur me arsimin, Musliu kërkoi që Drejtoria e Arsimit të ndajë më shumë mjete buxhetore për pajisjen e shkollave me tabela të mençura, duke vlerësuar se kjo do t'u mundësonte mësimdhënësve kushte më të mira pune dhe do të ndikonte pozitivisht në ngritjen e cilësisë së arsimit.

Ai gjithashtu theksoi se obligimet që rrjedhin nga Kontrata Kolektive duhet të planifikohen me kohë në buxhet, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë që krijohen nga procedurat përmbarimore.

Në emër të banorëve, Musliu paraqiti edhe kërkesën për rregullimin e rrugës që shpie drejt qytetit Antik, si një projekt me rëndësi për zhvillimin lokal dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Po ashtu, ai propozoi ndërtimin e një unaze rrugore në dalje të qytetit, e cila do të lidhej me fshatrat përreth, përfshirë Budisalcin dhe vendbanime të tjera, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe lehtësimit të qarkullimit të qytetarëve.

Përgjigja

Lidhur me çështjen e planifikimit të mjeteve për obligimet që rrjedhin nga kontrata kolektive, Kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Enver Berisha, sqaroi se këto obligime nuk mund të planifikohen në mënyrë të saktë në buxhet, për shkak se ato rrjedhin nga vendimet e gjykatave. Sipas tij, është e pamundur të specifikohet paraprakisht numri i rasteve dhe shuma e saktë e obligimeve që mund të krijohen, pasi përveç pagesës bazë ato përfshijnë edhe kamata, shpenzime procedurale dhe detyrime të tjera shtesë që përcaktohen nga organet kompetente.

Më pas, Drejtori i Arsimit, z. Qemajl Sejdiya, iu përgjigj kërkesës lidhur me investimet në arsim.

Ai theksoi se Drejtoria e Arsimit tashmë ka ndarë fonde për pajisjen e shkollave me tabela të mençura dhe se gjatë viteve të fundit janë realizuar investime të konsiderueshme në përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Ai shtoi se Komuna e Klinës është ndër komunat më korrekte në përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, po ashtu, theksoi se, megjithëse komuna po përballet me vështirësi financiare si pasojë e mungesës së mbështetjes së mjaftueshme nga Ministria e Arsimit, ajo vazhdon të përmbushë kërkesat dhe obligimet ndaj mësimeve.

Në fund, z. Sejdiya bëri të ditur se gjatë periudhës së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027–2029 janë paraparë investime të reja që synojnë ngritjen e mëtejshme të cilësisë së arsimit dhe përmirësimin e kushteve në institucionet arsimore.

Ai falënderoi të pranishmit për kontributin dhe interesimin e treguar.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryesuesi I Kuvendit deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 11:00

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	1
Burra	17
Totali	18

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu

